



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KURBIN
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Laç, më _____.____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Lyerje dhe meremetime të Shkollave (dhe mirëmbajtje elektrike dhe hidraulike), Bashkia Kurbin”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45442110-1 / 45330000-9 / 45311000-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 7,833,332.46 (shtatë milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e dy pikë dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kurbin ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Sigurimi i Ofertës: Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 ”Për prokurimin publik”, Neni 83:

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2% e fondit limit pa TVSH: 156,666 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik.

a) Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale.

Te jete i specifikuar ne QKB objekti i veprimtarise se operatorit ekonomik i njejte ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

Sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 8 te DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlloritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke qene lloji i procedures është “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa “c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: *”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:..... b) 40% te vlerës se përlloritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nen kufirin e ulët monetar.....”*.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: *”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”*.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument qe verteton se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitetet per vitin 2023 (sipas QKB) sipas percaktimeve ne ligjin 9632/2006 ” Per sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (**Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit**). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti Teknik (Aftësitë teknike dhe profesionale):

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme **për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 29%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar **gjatë pesë viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, **ku vlera monetare totale e punëve të kryera**, e marrë së bashku gjatë **pesë viteve të fundit**, është jo më e vogël se **vlera limit e kontratës që prokurohet**.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. **Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim** (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” të ndryshuar).

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

2.3.1/1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratën/at e sipërmarrjes;
- Situacionin përfundimtar të objektit;
- Aktin e kolaudimit;
- Faturën/at tatimore

2.3.1/2 Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;

2.3.1/3 Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 29 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatoret ekonomike duhet te paraqesë licensën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit,

klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- a. NP-2-A - Ndërtime civile dhe industriale
- b. NP-3-A - Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile industriale,veshje fasada.
- c. NS.1 –A - Punime per prishjen e ndertimeve

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjise, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit bashkengjitur ne SPE.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-2-A	Ndërtime civile dhe industriale	Sips zërave në preventiv kemi punime ndertimi	A	0 - 20 mln leke
NP - 3 A	Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile industriale,veshje fasada	Sips zërave në preventiv kemi -Suvatim mure tulle me krah. -Boje Hidroplastike etj.	A	0 - 20 mln leke
NS - 1 A	Punime per prishjen e ndertimeve	Prishje suvatimi ne secilin objekt	A	0 - 20 mln leke

Jane kerkuar keto pika license, pasi kemi punime mirembajtje dhe riparimi si dhe punime te thjeshta prishje. Gjithashtu eshte kerkua Klasifikimi A pasi punimet sipas preventivin punimet perfshihen ne vlerën (0-20 milion leke).

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

a. Inxhinier Ndertimi

1 (nje)

Inxhinieri i Ndertimit duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen muajn e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave si dhe të paraqese dokumentacionin si me poshte:

- Kontratë pune e vlefshme
- Diplomë
- Cv

Kjo kërkesë, *do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit)*. Ndërsa dokumentacioni provues, *do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.*

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- a. Specialiste Ndertimi/Karpentier/Murator – 3 (tre)**, per te cilet duhet te paraqese Kontrate pune te vlefshme, Çertifikatë ose Deshmi Kualifimi e Sigurimit Teknik si dhe te figurojne në listpagesat e shoqërisë minimumi muajn e fundit te deklaruar.
- b. Elektricit – 2 (dy)** per te cilet duhet te paraqese Kontrate pune te vlefshme, Çertifikatë ose Deshmi Kualifimi e Sigurimit Teknik si dhe te figurojne në listpagesat e shoqërisë minimumi muajn e fundit te deklaruar.
- c. Hidraulik – 2 (dy)** per te cilet duhet te paraqese Kontrate pune te vlefshme, Çertifikatë ose Deshmi Kualifimi e Sigurimit Teknik si dhe te figurojne në listpagesat e shoqërisë minimumi muajn e fundit te deklaruar.
- d. Puntore te thjeshte (te ndryshem) 10 (dhjetë)** per te cilet duhet te paraqese Kontrate pune te vlefshme, si dhe te figurojne në listpagesat e shoqërisë minimumi muajn e fundit te deklaruar.
- e. Bojaxhi 3 (tre)**, per te cilet duhet te paraqese Kontrate pune te vlefshme, Çertifikatë ose Deshmi Kualifimi e Sigurimit Teknik si dhe te figurojne në listpagesat e shoqërisë minimumi muajn e fundit te deklaruar.
- f. Shofere 2 (dy)**, të cilë duhet të jenë pjese e shoqerise ose te kontraktuar, si dhe te disponojne Kontrate pune te vlefshme dhe lejet e drejtimit per shoferet te vlefshme.

Kjo kërkesë, *do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit)*. Ndërsa dokumentacioni provues, *do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme pikat 2.3.3 dhe 2.3.4 janë përcaktuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c)

dhe 6/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Vendosja e ketyre kriterëve për fuqinë punetore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlogaritur në një kohë të shkurtër i cili kërkon fuqi punetore të shtuar dhe me mjetet e kerkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

Sqarohet se është kërkuar një Ing. Ndertimi Drejtues teknik për drejtimin, kontrollin e punimeve në të gjitha objektet. Specialitetet e ndertimit duhen për të kryer punimet e suvatimit dhe riparimet e ndryshme gjatë punës. Puntoret e thjeshtë janë kërkuar për të përgatitur materialin e gatshëm, për të furnizuar specialistet dhe bojaxhite, transportin dhe montimin e materialeve të domosdoshme. Bojaxhi janë kërkuar për të bërë lyrjen e cdo objekti në bashkëpunim me puntoret e thjeshtë. Elektricitet janë kërkuar për F-V materialeve elektrike. Hidraulik janë kërkuar për F-V materialeve hidraulike. Shoferet janë kërkuar pasi nevojitet për të drejtuar mjetet si dhe numri i tyre është vendosur në bazë të makinerive që janë kërkuar.

Gjithashtu Njësia e Prokurimit për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punetore dhe stabilitetin e saj ka kërkuar dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Nenin 39, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- **1 (një)** punonjës, pjesë e stafit të shoqërisë, duhet të jetë i pajisur me certifikate të Trajnimit për **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në Punë”**, e dhënë nga një organizim i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj, i cili duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën muajn e fundit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështet në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe ligjin 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit” i ndryshuar, ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri të përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë **Drejtnuesin Teknik të punimeve në objekt**, dhe të deklarojë se ai është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate. Bashkelidhur deklaratës për Drejtnuesin Teknik duhet të paraqitet; Kontrata e punës e vlefshme, Diploma.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 39, pika 6, germa c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Eshtë vendosur ky kriter duke u bazuar në ligjin 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit” datë 10.09.1998 i ndryshuar, pasi për çdo objekt zbatimi duhet të ketë drejtnuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij në përputhje me këtë ligj dhe vendim Nr.312, datë 5.5.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **30 (tridhjetë) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit **për periudhën muaj e fundit të deklaruar**, e vertetuar kjo me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj.
- b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bere në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlllogaritur në një afat kohor prej 35 dite / (5 javë), i cili kërkon fuqi punëtore si dhe bazuar në mjetet e kerkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate. Kapaciteti për fuqi punëtore i kerkuar në këtë kërkesë për kualifikim bazohet në K.Punës, legjislacionin për sigurimet shoqërore (pushimet, leje e zakonshme).

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës etj. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje për

periudhen muajn e fundit te deklaruar, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrate tatimre e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- Automjet transporti (3-5 ton) 2 cope
- Kamionçina 4 cope
- Motobetoniere (250 L) 4 cope
- Pompe uji 4 cope
- Autobot Uji 1 cope
- Mjete e vegla pune suvatimi e bojatisje
- Skeleri + armatura derrase 1000 m²

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit si: - **çertifikaten e pronësisë, -leja e qarkullimit; - çertifikaten e kontrollit teknik** (e vlefshme); **siguracionin** (i vlefshëm); **Taksat Vjetore** (te vlefshme).

Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

b) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.

c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera si dhe deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë mbi vendodhjen e mjeteve.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesat e mesiperme janë vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe Nenit 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme

për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qera janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike (hartuar nga DPKZHT). Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative.

Numri i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikata te vlefshme:

- ISO 9001:2015 (*Sistemi i menaxhimit të cilesisë*) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- ISO 14001:2015 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë .
- ISO 45001-2018 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Argumentimi: Në bazë të nenit 39, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, të ligjit Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar.

Shënim: Ne zbatim te pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...*”, **sjellim ne vemendje se:**

- Disponimi i dokumentave të kërkuara më sipër do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet t’i dergoje kerkese ne rruge elektronike (nëpërmjet sistemit të APP) ofertuesit te kualifikuar i pari, që të dorëzojë dokumentet provuese/mbështetëse për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Mosparaqitja e dokumentacionit do te jete kusht s’kualifikimi si dhe do të veprohet sipas nenit 83 pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bëra gjatë fazes së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Autoriteti Kontraktor ka marrë në konsideratë parashikimet e vendimit Nr.1339/2023 të KPP.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike jane hartuar ne perputhje me nenin 36, te LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **sipas shkresës Nr.2809 Prot, date 12.06.2024 (e cila eshte bashkëlidhur dosjes).**

Jane hedhur se bashku me dokumentat teknike te tenderit ku jane shprehur qarte kerkesat AK per cilesine e te gjithë punimeve per realizimin e kontrates, ne te cilin jane argumentuar cdo ze punimesh i parashikuar ne projekt-preventiv nga specialistet e fushes (DPKZHT).

Ne specifikimet teknike qe jane hedhur ne dokumentet teknike te tenderit nuk eshte përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e kësaj procedure, Njësia e Prokurimit autorizon personin përgjegjës për prokurimin.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT:

1. Pjeter Bushi Kryetar (Përsoni përgjegjës)
2. Ing. Jonida Merlika Anëtar
3. Elvis Guraj Anëtar